



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni Pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-011
Prishtinë, më 9 shkurt 2015, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 9 SHKURT 2015

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca dhe Duda Balje, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Elmi Reçica, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Donika Kadaj-Bujupi, Valdete Bajrami dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Blerim Latifi;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Emrush Haxhiu, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga OSBE-ja: Floriana Shala dhe

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati.

Mbledhjen e kryesoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe dy pika shtesë, të cilat i miratoi Kryesia e Kuvendit

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 2 shkurt 2015,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave dhe
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 2 shkurt 2015

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 2 shkurt 2015.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Lidhur me përgatitjet për seancën plenare të radhës, përkatësisht pikën 2.5 të rendit të ditës - Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-09 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike diskutuan: Valdete Bajrami, Ismet Beqiri, Xhavit Haliti, Visar Ymeri, Donika Kadaj-Bujupi dhe Elmi Reçica. Diskutimet e tyre janë dhënë në transkript.

Në fund, Kryesia me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare e radhës të mbahet më 12 shkurt 2015, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. *Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
2. *Koha për pyetje parlamentare,*
3. *Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,*
4. *Propozim-programi i punës së Kuvendit për vitin 2015,*
5. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-09 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike,*
6. *Propozimi për emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës,*
7. *Propozimi i grupeve parlamentare për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.*

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave:

1. Propozim-programi i punës së Kuvendit për vitin 2015

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan nënkryetarët e Kuvendit Sabri Hamiti dhe Xhavit Halit, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pas diskutimeve, Propozim-programin e punës së Kuvendit për vitin 2015 e radhiti pikë nr. 4 të rendit të ditës për seancën plenare, që do të mbahet më 12 shkurt 2015.

2. Kërkesa e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financa Publike për auditimin e raporteve financiare dhe raportit të deklarimit financiar të fushatës, të cilat dorëzohen nga subjektet politike në KQZ për vitet 2013 dhe 2014

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

Përfundim

1. Ngarkohet Administrata e Kuvendit, përkatësisht Drejtoria e Prokurimit që t'i ndërmarrë veprimet e nevojshme për të bërë thirrje të hapur për aplikim për përzgjedhjen e së paku 10 auditorëve të licencuar, të cilët do t'i auditojnë raportet financiare dhe raportet e deklarimit financiar të fushatës, të cilat dorëzohen nga subjektet politike në KQZ për vitet 2013 dhe 2014.

2. Mjetet buxhetore për përmbushjen e obligimit të cekur në paragrafin 1 (një) të këtij përfundimi barten nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

3. Rekomandimi i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me kërkesën e Bankës Qendrore për aprovimin e Auditorit të Jashtëm për auditimin e BQK-së për periudhën 2014-2016

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me rekomandimin e lartshënuar, nxori këtë:

Vendim

Aprovohet rekomandimi i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me kërkesën e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, sipas raportit të Komisionit Vlerësues për shpalljen fituese të kompanisë audituese për auditimin e BQK-së për vitet 2014-2016, ngase sipas komisionit vlerësues kushtet e dosjes së tenderit i ka plotësuar operatori ekonomik "Deloitte Kosova, shpk".

4. Përzgjedhja e kompanisë audituese për auditimin e pasqyrave vjetore financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2014

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me pikën e lartshënuar, nxori këtë:

Përfundim

1. Autorizohet Administratën e Kuvendit, përkatësisht Drejtoria e Prokurimit që të bëjë përzgjedhjen e kompanisë audituese për auditimin e pasqyrave vjetore financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2014.

2. Pas përzgjedhjes së kompanisë audituese, Drejtoria e Prokurimit duhet ta njoftojë me shkrim Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

3. Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, pas përfundimit të procesit të auditimit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, e njofton Kryesinë e Kuvendit.

5. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtarë për pjesëmarrjen në Konferencën Ndërparlamentare, të organizuar nga Parlamenti Evropian, në Bruksel

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë së Parlamenti Evropian i ka ftuar (4) katër deputete nga Kuvendi i Kosovës për të marrë pjesë në Konferencën Ndërparlamentare dhe takimin ndërparlamentar që do të mbahet në Bruksel nga data 3-6 mars 2015.

Ai tha se nga Kryesia e Kuvendit kërkohet që të propozohen dhe përzgjidhen (4) katër deputete për të marrë pjesë në këtë konferencë.

Lidhur me kërkesën e lartpërmendur diskutuan: Sabri Hamiti dhe Xhavit Haliti, Donika Kadaj-Bujupi, Myfera Shinik, Ismet Beqiri dhe Visar Ymeri, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën për pjesëmarrje në punimet e konferencës së lartshënuar, vendosi që (1) një deputete të propozohet nga GP i PDK-së, (1) një deputete nga GP i LDK-së, (1) një deputete nga GP i VV dhe (1) një deputete nga GP “6+”.

Kryesia në parim e miratoi kërkesën për udhëtim zyrtar, por kërkoi nga grupet parlamentare që t'i propozojnë deputetet që do të marrin pjesë në konferencën e lartshënuar.

6. Njoftimi për formimin e Grupit të Grave Deputete dhe vazhdimi i kontratës së asistentit për mbështetjen e këtij grupi

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë së Grupi i Grave Deputete e ka njoftuar Kryesinë e Kuvendit për formimin dhe zgjedhjen e Bordit të këtij grupi. Ai tha se ne sot duhet të marrim vendim për angazhimin e një asistenti/eje për t'i mbështetur aktivitetet e Grupit joformal të grave deputete dhe Grupit joformal të deputetëve të rinj.

Lidhur me kërkesën e lartshënuar diskutuan Xhavit Haliti dhe Duda Balje, diskutimet e të cilëve janë dhen në transkript.

Kryesia, pas diskutimeve lidhur me angazhimin e një asistenti/eje për t'i mbështetur aktivitetet e Grupit joformal të grave deputete dhe Grupit joformal të deputetëve të rinj, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet kërkesa për angazhimin e një asistenti/eje për t'i mbështetur aktivitetet e Grupit joformal të grave deputete dhe Grupit joformal të deputetëve të rinj sipas kontratës së veçantë.
2. Ngarkohet Administrata e Kuvendit që ta zbatojë këtë vendim.

Pikat shtesë:

1. Shkresa e kryeministrit të Kosovës për ta informuar Kuvendin e Kosovës për takimin e tij me kryeministrin e Serbisë

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë lidhur me shkresën e kryeministrit Isa Mustafa, i cili ka shprehur gatishmërinë e tij për ta informuar Kuvendin e Kosovës për takimin e tij, të realizuar më 9 shkurt 2015, në Bruksel, me kryeministrin e Serbisë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës diskutuan Sabri Hamiti, Xhavit Haliti dhe Visar Ymeri, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pasi diskutoi për çështjen e lartshënuar, e miratoi në parim kërkesën e kryeministrit dhe mirëpriti gatishmërinë e tij për ta informuar Kuvendin e Kosovës për takimin e realizuar me kryeministrin e Serbisë.

Lidhur me datën se kur do ta informojë Kuvendin do të dihet pas komunikimit zyrtar që kryetari i Kuvendit do ta ketë me kryeministrin Isa Mustafa.

2. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar të delegacionit të Kuvendit të Kosovës në Shqipëri

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i delegacionit të Kuvendit, në këtë përbërje: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti dhe Glauk Konjufca, nënkryetarë të Kuvendit; Uran Ismaili, Burhan Selimi, Blerim Latifi dhe Valon Xhaferi, këshilltarë të kryetarit; Bashkim Rrahmani, zyrtar për siguri dhe ndërlidhje; Naser Shala, zyrtar për siguri-vojitës; Azem Mjekiqi, zyrtar për siguri (Policia e Kosovës); Iljas Gërbeshi, zyrtar për siguri (Policia e Kosovës); Fadil Sfishta, vozitës; Arsim Shala, vozitës; Ramadan Deliu, vozitës; Shpresim Shala, fotograf (bashkëpunëtor i jashtëm); Rrahim Llallosi, vozitës, si dhe Shaban Selimi, nga Administrata e Kuvendit, në Shqipëri, prej datës 9-11 shkurt 2015.

2. Të gjitha shpenzimet për realizimin e këtij udhëtimi për të lartshënuarit në pikën (1) një të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Të ndryshme:

1. Shqyrtimi i vendimit për përfitimin e privilegjeve që i takojnë me ligj ish- kryetarit të Kuvendit, Jakup Krasniqi

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë së Kuvendit me kërkesën e parashtruar në korrik të vitit 2014 nga ish-kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, si dhe vendimin e miratuar nga Kryesia e Kuvendit lidhur me këtë çështje.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me vendimin e miratuar më 21 janar 2015 për ish-kryetarin e Kuvendit, z. Jakup Krasniqi, konstatoi se duhet kërkuar një interpretim ligjor nga Drejtoria e Përgjithshme për Çështje Ligjore dhe Procedurale dhe pastaj në mbledhjen e radhës të vendoset për këtë çështje.

2. Kërkesa e kryetarit të Kuvendit drejtuar Kryesisë së Kuvendit miratimin për funksionalizimin e Kabinetit të tij

Kryesia, pasi u njoftua nga kryetari për përbërjen e re të Kabinetit të tij, e miratoi propozimin për funksionalizimin e Kabinetit të kryetarit të Kuvendit.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë në orën 12:30 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për çështje plenare dhe procedurale